



Në bazë të nenit 22, paragrafit 1 alinejës 1 dhe paragrafit 3 të Ligjit për Marëdhënie Pune (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 62/05, 106/08, 161/08, 130/09, 114/09, 130/09, 10/12, 11/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15 dhe 27/16), Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor shpall:

SH PA LL J E NR. 1/2016

Për punësimin e tetë përmaruesve në kohë të caktuar në Njësinë projektuese për zbatimin e projektit "Rindërti dhe zgjerimi i rrjetit të kanalizimit dhe ndërtimi i stacionit për trajtimin e ujërave të zeza"

1. Udhëheqës në njësinë projektuese për zbatimin e projektit "Rindërti dhe zgjerimi i rrjetit të kanalizimit dhe ndërtimi i stacionit për trajtimin e ujërave të zeza" 1 përmarues

Njësia projektuese për zbatimin e projektit „ Rikonstruksioni dhe zgjerimi i rrjetit të kanalizimit dhe ndërtimi i stacionit për trajtimin e ujërave të zeza “

- Arsimi i lartë, me të paktën 240 kredite sipas EKTC ose të përfunduar shkallën e VII / 1 në Fakultetin e Maqinerisë, Fakultetin e Ndërtimtarisë, Fakultetin e Arkitekturës ose Fakultetin Teknologjik – Metalurgjik
- Së paku 5 vjet përvojë pune
- Njohje të rregullativës së BE-së
- Njohuri në fushën e fondeve paraqasëse
- Njohje të gjuhës angleze
- Puna me kompjuter (Word, Excel)
- Orari i punës: E hënë - E premte prej ora 08:30 deri në ora 16:30
- Paga neto: 28. 278 denarë

2. Këshilltarë për monitorimin e zbatimit të projekteve të infrastrukturës 6 përmarues

Njësia projektuese për zbatimin e projektit „ Rikonstruksioni dhe zgjerimi i rrjetit të kanalizimit dhe ndërtimi i stacionit për trajtimin e ujërave të zeza “

- Komunat - lokacioni i vendit të punës:

Kumanovë – 1 përmarues

Berovë – 1 përmarues

Radovish – 1 përmarues

Kërçovë – 1 përmarues

Strumicë – 1 përmarues

Strugë – 1 përmarues



- Arsimi i lartë, me të paktën 240 kredite sipas EKTC ose të përfunduar shkallën e VII / 1 në Fakultetin e Ndërtimtarisë, Fakultetin e Arkitekturës dhe Fakultetin e Maqinerisë (Drejtime: Energjetika dhe ekologjia dhe Inxhinieria hidraulike dhe menaxhimi i ujërave)
- Së paku 3 vjet përvojë pune
- Njohje të gjuhës angleze
- Puna me kompjuter (Word, Excel)
- Orari i punës: E hënë - E premte prej ora 08:30 deri në ora 16:30
- Paga neto: 24.998 denarë

3. Referent i pavarur për dokumentim 1 përmbarues

Njësia projektuese për zbatimin e projektit „ Rikonstruksioni dhe zgjerimi i rrjetit të kanalizimit dhe ndërtimi i stacionit për trajtimin e ujërave të zeza “

- Së paku 3 vjet përvojë pune
- Njohje të gjuhës angleze
- Puna me kompjuter (Word, Excel)
- Orari i punës: E hënë - E premte prej ora 08:30 deri në ora 16:30
- Paga neto: 15.683 denarë

Krahas kushteve të veçanta kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet e përgjithshme në përputhje me Ligjin.

Vendi i punës me numër 1 dhe 3 gjindet në Shkup, e me numër 2 gjindet në 6 komuna.

Kandidatët e interesuar nevojitet që të dorëzojnë fletëparaqitje (letër interesi), në të cilën do të specifikojnë se për cilin vend pune aplikojnë, biografi të shkurtër, kopje të diplomës ose certifikatës së përfundimit të shkollimit dhe dëshmi të përvojës së punës.

MMJPH synon që të sigurojë përfaqësim të barabartë të grave dhe minoriteteve në të gjitha aktivitetet e saja, dhe i inkurajon të gjithë kandidatët që janë të interesuar dhe i plotësojnë kushtet të aplikojnë në këtë shpallje.

Fletëparaqitjet me dokumentet për përmbushjen e kërkesave të dorëzohen me postë në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, bul. Goce Delçev nr. 18 ose personalisht në arkivin e Ministrisë (ndërtesa e RTVM-së kati i 10-të).



Afati i paraqitjes 5 ditë llogaritur nga dita e shpalljes.

Dokumentacioni i vonuar dhe i pa-kompletuar nuk do të shqyrtohet. Në intervistë do thirren vetëm kandidatët që i plotësojnë kushtet. Të gjithë kandidatët të cilët janë paraqitë do të kenë mundësi të barabarta që të pranohen në bazë të aftësive të tyre, arsimimit, përvojës së punës dhe kapacitetit personal.

